



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 49

2002

Gusht

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8925, datë 22.7.2002	Për miratimin e aktit normativ nr.5, datë 13.6.2002 të Këshillit të Ministrave, me fuqinë e ligjit, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8002, datë 27.9.1995 “Për përdorimin dhe administrimin e pullave të taksave”.....	1439
Ligj nr.8931, datë 25.7.2002	Për miratimin e aktit normativ nr.6, datë 4.7.2002 të Këshillit të Ministrave, me fuqinë e ligjit, “Për miratimin e fondit për partitë politike, pjesëmarrëse në zonën zgjedhore nr.19, për zgjedhjen e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”..	1440
Vendim i GjK nr.166, datë 24.7.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.190, datë 6.4.2001 të Gjykatës së Apelit të Vlorës dhe nr.21, datë 10.1.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	1441
Vendim i GjK nr.167, 26.7.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.847, datë 25.4.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	1443

Vendim i GjK nr.168, datë 26.7.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.152, datë 15.2.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	1445
Vendim i GjK nr.169, datë 26.7.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.93, datë 10.7.2002 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	1447
Vendim i GjK nr.171, datë, 30.7.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të nenit 22 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”.....	1449
Vendim i GjK nr.172, datë 31.7.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.31, datë 20.1.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; nr.236, datë 21.2.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.Xh-3, datë 17.7.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	1451
Vendim i KKRT nr. 101, datë 23.7.2002	Mbi pavlefshmërinë dhe heqjen e licencave për disa subjekte radio e televizive	1453
Vendim i KKRT nr. 102, datë 23.7.2002	Për dhënie licence për ritransmetim të programeve të huaja radio në Shqipëri “Radio Italia”	1455
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Gjon Bib Nikolli	1455

LIGJ
Nr. 8925, datë 22.7.2002

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV NR.5, DATË 13.6.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, ME FUQINË E LIGJIT, “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
LIGJIN NR.8002, DATË 27.9.1995 “PËR PËRDORIMIN DHE ADMINISTRIMIN E
PULLAVE TË TAKSAVE””**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet akti normativ nr.5, datë 13.6.2002 i Këshillit të Ministrave, me fuqinë e ligjit, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8002, datë 27.9.1995 “Për përdorimin dhe administrimin e pullave të taksave””.

Shpallur me dekretin nr. 3423, datë 7.8.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

AKT NORMATIV
Nr. 5, datë 13.6.2002

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8002, DATË 27.9.1995 “PËR
PËRDORIMIN DHE ADMINISTRIMIN E PULLAVE TË TAKSAVE”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Fjala e parë e nenit 5 të ligjit nr.8002, datë 27.9.1995 zëvendësohet me:
“Pullat e taksave të jenë me vlerë deri në 100 lekë për njësi, ndërsa pullat e taksave të shprehura në valutë (USD) të jenë me vlerë deri në 30 USD.”.

Neni 2

Në listën nr. 1 “Aktet dhe dokumentet për të cilat do të përdoren pullat e taksës”, pas shkronjës “D” shtohet shkronja “Dh”, me këtë përmbajtje:
“Dh. Taksat për shërbimet konsullore.”.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LIGJ
Nr. 8931, datë 25.7.2002

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV NR.6, DATË 4.7.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, ME FUQINË E LIGJIT, “PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR PARTITË
POLITIKE, PJESËMARRËSE NË ZONËN ZGJEDHORE NR.19, PËR ZGJEDHJEN E
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet akti normativ nr.6, datë 4.7.2002 i Këshillit të Ministrave, me fuqinë e ligjit, “Për miratimin e fondit për partitë politike, pjesëmarrëse në zonën zgjedhore nr.19, për zgjedhjen e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”.

Shpallur me dekretin nr. 3433, datë 7.8.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

AKT NORMATIV
Nr. 6, datë 4.7.2002

**PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR PARTITË POLITIKE, PJESËMARRËSE NË ZONËN
ZGJEDHORE NR.19, PËR ZGJEDHJEN E DEPUTETIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t’i jepet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh për financimin e partive politike, pjesëmarrëse në zonën zgjedhore nr. 19, për zgjedhjen e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 166, datë 24.7.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar	i	“	“
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Zija Vuci	Anëtar	i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 10.6.2002 e 18.6.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.125 Akti që i përket:

KËRKUES:

1. GRAMOZ ISMAILI, ISLAM QEMALI, FASLLI ÇELA, përfaqësuar nga avokat Arben Hakani, me prokurë.

2. ABAZ KASA.

3. MEHMET RRAPAJ, në mungesë.

4. XHEVAHIR ISMAILI, në mungesë.

5. VASIL KUMRAKU.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. SHEFQET GLLAVA, SANIJE MYFTARI (GLLAVA), përfaqësuar nga avokat Riza Xhixho, me prokurë.

2. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE BERAT, përfaqësuar nga juristi Arben Allajbeu, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.190, datë 6.4.2001 të Gjykatës së Apelit të Vlorës dhe nr.21, datë 10.1.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41/1, 42/1, 131/f e 134/b të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e këtyre vendimeve kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe:

Gjykata e apelit, duke u shprehur për mungesën e legjitimitit të kërkuesve në ngritjen e padisë dhe mbi këtë bazë, duke vendosur rrëzimin e kësaj padie, nuk ka pasur parasysh se me këtë zgjidhje ajo i ka lejuar vetes të formulojë një vendim kontradiktor. Kjo, për arsye se ajo vetë ka pranuar që prona e tyre është cenuar pjesërisht, fakt i cili i legjitimon ata për të kërkuar mbrojtjen e këtij interesi të tyre të ligjshëm, prandaj, në këtë rast, vetëm mund të pushonte gjykimin, por jo ta zgjidhte çështjen në themel, duke vendosur rrëzimin e padisë.

Veç kësaj, në shqyrtimin e kësaj çështjeje ajo nuk ka respektuar as parimin për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Të tre gjyqtarët që e kanë gjykuar atë, kanë gjykuar një çështje tjetër, e cila ka pasur si objekt të njëjtën sipërfaqe trualli dhe megjithëse është kërkuar për këtë shkak përjashtimi i tyre, një trup tjetër gjykues i kësaj gjykate, padrejtësisht, ka vendosur refuzimin e kësaj kërkesë.

Gjatë këtij gjykimi janë lejuar edhe shkelje të tjera procedurale. Në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, kjo gjykatë ka marrë për bazë mendimin e ekspertit që ka mbetur në minorancë, pa arsyetuar për shkakun e mospranimit të mendimeve që kanë dhënë dy ekspertët e tjerë.

Përsa i përket vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, janë ngritur probleme ligjore dhe, për rrjedhojë, çështja duhej të kalonte për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhe jo të mbyllej me mospranim në dhomën e këshillimit.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, përfaqësuesit e kërkuësve, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Beratit, me vendimin nr.36, datë 31.1.2000, ka vendosur pranimin e padisë së kërkuësve Gramoz Ismaili, etj. dhe ndryshimin e vendimit nr.201/1, datë 27.12.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Berat, duke iu njohur subjekteve të interesuara, Shefqet e Sanije Gllava, vetëm të drejtën e kompensimit në vlerë të një trualli me sipërfaqe 10400 m², të ndodhur në fshatin Poshnje të Beratit.

Mbi ankimin e këtyre të fundit, Gjykata e Apelit të Vlorës me vendimin nr.190, datë 6.4.2001, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit dhe duke e gjykuar çështjen në fakt, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar.

Kërkuësit, duke mos u pajtuar me këtë zgjidhje, kanë ushtruar rekurs pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, por ai ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit si të pabazuar në ligj.

Gjykata Kushtetuese, duke analizuar shkaqet e parashtruara nga kërkuësit, çmon se pretendimet e tyre janë të pabazuara, pasi nuk lidhen me shkelje që cenojnë procesin e rregullt ligjor. Kështu, nga provat e administruara në seancë plenare dhe aktet e tjera që gjenden në dosjen gjyqësore, sipas vlerësimit që iu ka bërë atyre gjykata e apelit, del se sipërfaqja e truallit e pretenduar nga kërkuësit nuk ndodhet brenda pronës që u është kthyer subjekteve të interesuara nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Berat. Për rrjedhojë, kjo gjykatë ka arritur në konkluzionin se ata nuk legjitimohen në ngritjen e padisë dhe, për këtë shkak, ka vendosur rrëzimin e saj dhe jo pushimin e gjykimit të çështjes. Problemi i legjitimitimit në këtë rast është i lidhur me vlerësimin e provave dhe për këtë shkak nuk ka të bëjë me procesin e parregullt ligjor, prandaj ai nuk i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës Kushtetuese.

Të pabazuara janë edhe pretendimet e tjera të kërkuësve lidhur me mosrespektimin nga Gjykata e Apelit të Vlorës të parimit për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në këtë drejtim ata kanë parashtruar se të tre gjyqtarët e kësaj gjykate kanë pasur pengesa ligjore për gjykimin e kësaj çështjeje. Megjithatë, nga dosja gjyqësore del se kërkesën për përjashtimin e tyre e kanë bërë vetëm subjektet e interesuara. Përkundrazi, kërkuësit, gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë nga një trup gjykuës i gjykatës së apelit, janë shprehur për mospranimin si të pabazuar të një kërkesë të tillë.

Duke u nisur nga kjo dhe meqënëse çështja tjetër që gjyqtarët e gjykatës së apelit kanë gjykuar nuk ka lidhje me çështjen në gjykim për shkak se kërkuësit nuk kanë qenë palë në gjykimin e parë, ky kolegji i kësaj gjykate, ka dalë me konkluzionin se nuk ka shkaqe ligjore për përjashtimin e këtyre gjyqtarëve. Po kështu, në kundërshtim me sa kanë parashtruar kërkuësit, fakti se gjykata e apelit e ka bazuar vendimin e saj për rrëzimin e padisë së tyre në mendimin që ka dhënë njëri prej tre ekspertëve, pa arsyetuar pse ajo nuk është dakord me konkluzionet e kundërta të dy ekspertëve të tjerë, nuk e bën procesin e parregullt në kuptimin kushtetues. Kjo për arsye se siç u theksua edhe më lart, çmimi i provave është atribut i gjykatës së rrethit dhe i gjykatës së apelit. Nga ky këndvështrim e ka parë edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë përmbajtjen e rekursit që kanë ushtruar kërkuësit kundër vendimit të gjykatës së apelit, kur është shprehur se në të nuk ngrihen probleme ligjore, por vetëm pretendime që lidhen me vlerësimin e provave.

Në këto kushte, zgjidhja e çështjes me mospranim të rekursit, është në pajtim me funksionin që kryen kolegji civil në dhomën e këshillimit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 167, datë 26.7.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar	i	“	“
Gjergj Sauli	Anëtar	i	“	“
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica e Drita Panda, në datat 20.6.2002 dhe 27.6.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.126 Akti që i përket:

KËRKUES: SHOQËRIA “ORTENSIO” SH.P.K. KAVAJË, përfaqësuar nga avokat Avni Shehu, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. AVOKATI I SHTETIT, përfaqësuar nga zoti Kadri Skera, me autorizim.
2. DEGA E TATIM TAKSAVE KAVAJË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.847, datë 25.4.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e këtij vendimi kërkuar ka parashtruar këto shkaqe:

1. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka zbatuar ligjin që ishte në fuqi në kohën e caktimit të detyrimit, por i është referuar ligjit që ishte në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes. Në këto raste, sipas nenit 155 të Kushtetutës, ligjit nuk mund t’i jepet fuqi prapavepruese.
2. Në kohën e caktimit të detyrimit, pullat ishin hequr nga qarkullimi me urdhër të Ministrit të Financave.
3. Në kundërshtim me ligjin e kohës, detyrimi është caktuar mbi mallin e paprodhuar e të pashitur.
4. Në caktimin e detyrimit nuk është patur parasysh çmimi në kohën e furnizimit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Kristofor Peçi, përfaqësuesin e kërkuetit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Mbi padinë e kërkuetit ndaj të paditur Dega e Tatim Taksave Kavajë, me objekt kundërshtimin e detyrimit fiskal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Kavajës me vendimin nr.163, datë 13.5.1999 ka rrëzuar padinë. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.419, datë 6.7.1999, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit dhe pranimin e padisë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.847, datë 25.4.2000, ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit.

Për të verifikuar pretendimin e kërkuetit për proces të parregullt dhe për të kontrolluar kushtetutshmërinë e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese analizoi rrethanat dhe veprimet konkrete të shqyrtuara dhe të pranuar gjatë gjykimit. Kërkueti pretendon se detyrimi tatimor, i cili i është komunikuar shoqërisë në datën 26.11.1998, është caktuar në bazë të ligjit nr.7678, datë 3.3.1993 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet që janë bërë me ligjin nr.8247, datë 2.10.1997 dhe se Gjykata e Lartë për zgjidhjen e çështjes i referohet ligjit të mëvonshëm nr.8437, datë 28.12.1998. Në këtë mënyrë, sipas kërkuetit, detyrimi tatimor i akcizës është në kundërshtim me ligjin, sepse është caktuar mbi mallin e paproduar e të pashitur. Por, duke iu referuar ligjit nr.8247, datë 2.10.1997 që përmend kërkueti, rezulton se për pijet alkoolike, akciza paguhet që me blerjen e pullës, dhe jo pas prodhimit dhe shitjes së mallit, siç pretendohet nga kërkueti. Kështu, në nenin 2 të këtij ligji përcaktohet: “Për cigaret, purot dhe pijet alkoolike të importuara dhe të prodhuara në vend, akciza do të paguhet me blerjen e pullës”. Këtë rregullim ka bërë edhe ligji nr.8437, datë 28.12.1998, të cilit i referohet në vendim Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Për më tepër, ky kolegji arsyeton se në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, pullat fiskale janë letra me vlerë dhe për to nuk pranohen deklarime për humbjen, dëmtimin apo vjedhjen e tyre.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka zhvilluar proces të parregullt, por ka zbatuar drejt ligjin për zgjidhjen e çështjes dhe nuk i ka dhënë atij fuqi prapavepruese. Detyrimi i kërkuetit për të paguar akcizën parashikohet si në ligjin e mëparshëm të cilit ai vetë i referohet, ashtu edhe në ligjin e ri të përmendur nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit nenit 132/1 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 168, datë 26.7.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar	i	“	“
Gjergj Sauli	Anëtar	i	“	“
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 12.7.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.124 Akti që i përket:

KËRKUES: ANASTAS KOSTRICA, përfaqësuar nga avokat Isllam Llapi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. BASHKIA FIER, në mungesë.

2. MEDIHA MERDANI, përfaqësuar nga avokat Shpëtim Baçi, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.152, datë 15.2.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi pretendon se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është antikushtetues, sepse i ka mohuar të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe të drejtën e mbrojtjes.

Ai pretendon:

- Në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë ka parashtruar se gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin për kthimin e pronave dhe, konkretisht, nuk kanë zbatuar drejt nenet 4 dhe 15 të tij. Ky zbatim i gabuar që gjykatat i kanë bërë ligjit ka qenë i mjaftueshëm për Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë që çështjen ta kalonte për shqyrtim në seancë gjyqësore.

- Shteti ia ka shitur truallin nën një objekt të përkohshëm dhe pa themele subjektiviteti të interesuar, ndërkohë që pronari i truallit, sipas ligjit për kthimin e pronave, e kishte të drejtën për ta gëzuar vetë këtë pronë.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit, të subjektiviteti të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier i ka njohur pronësinë kërkuesit mbi një sipërfaqe 3114 m², me të drejtë kompensimi, sepse trualli ka qenë i zënë. Kërkuesi e ka kundërshtuar këtë vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave në gjykatë, për arsye se brenda truallit ka patur sipërfaqe të lira, mbi të cilat janë ngritur ndërtime pa leje.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier i ka rrëzuar padinë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr.152, datë 15.2.2002, ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit.

Pretendimet që ka ngritur kërkuesi përpara Gjykatës Kushtetuese nuk lidhen me shkeljen e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se jurisprudenca e saj kushtetuese është konsoliduar tashmë në drejtim të krijimit të një koncepti sa më të qartë të të drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, duke orientuar dhe argumentuar se jo çdo shkelje procedurale apo ligjore prek detyrimisht këtë parim kushtetues.

Pretendimet e ngritura nga kërkuesi lidhen me aspekte të të provuarit e me zgjidhjen në themel të çështjes dhe nuk kanë të bëjnë me cenimin e të drejtës kushtetuese të tij për një proces të rregullt ligjor. Mënyra e vlerësimit të provave, që përbën pretendimin kryesor në kërkesën e paraqitur dhe që lidhet me faktin nëse trualli ndërmjet pallateve ka qenë i lirë apo i zënë, pretendim i cili është ngritur edhe në rekursin drejtuar Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përbën një atribut të gjykimit të kryer nga gjykatat e sistemit të zakonshëm dhe nuk mund të përfshihet në jurisprudencën kushtetuese. Sipas nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile, është e drejtë e Kolegjit Civil në dhomën e këshillimit të analizojë dhe vlerësojë përputhjen me kërkesat e ligjit të shkaqeve të ngritura në rekurs. Analiza që bën Kolegji nuk mund t'i heqë atij të drejtën për të vendosur mospranimin e rekursit, kur bindet se shkaqet e ngritura në rekurs nuk lidhen me çështje të ligjit, por me mënyrën e të vlerësuarit të provave nga gjykatat e hallkave më të ulëta.

Në këto kushte, marrja nga Gjykata Kushtetuese e attributeve të gjykatave të zakonshme, pavarësisht nga zgjidhja që ato i japin çështjeve në fakt, por që nuk lidhen me parimin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor, do ta spostonte këtë Gjykatë nga funksionet e saj.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e paraqitur nga Anastas Kostrica, nuk është e drejtë dhe duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 132 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 169, datë 26.7.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar	i	“	“
Gjergj Sauli	Anëtar	i	“	“
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 23.07.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.171 Akti që i përket:

KËRKUES:

1. GAFUR MUKA, kandidat për deputet i subjektit elektoral PD+BF, përfaqësuar nga avokat Ilirjan Rusmajli, me deklaram.

2. PARTIA KONSERVATORE E SHQIPËRISË, përfaqësuar nga kryetari Armando Ruço e Denis Selimi, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. ARDIT KAJA, kandidat për deputet i PS-së, përfaqësuar nga avokat Baftjar Rusi, me prokurë.

2. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga sekretari Sokol Shazi e juristja Dëshira Mataj, me autorizim.

3. PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË, përfaqësuar nga avokat Shpëtim Baçi, me prokurë.

4. PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË, në mungesë.

5. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.19, përfaqësuar nga kryetari Selim Daci.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.93, datë 10.7.2002 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: Nenet 141/1 e 113/1 të Kodit Zgjedhor.

Për shfuqizimin e këtij vendimi kërkuesit kanë parashtruar:

Kërkuesi Gafur Muka:

- Në qendrat e votimit nr.19, 21, 22, 27 e 41 të zonës zgjedhore nr.19, anëtarë të veçantë të familjeve kanë votuar në emër të gjithë familjes. Kjo procedurë votimi është në kundërshtim të hapur me parimin “një zgjedhës një votë”.

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve iu shmang hetimit të rrethanave e fakteve që shoqëronin kërkesën për deklarimin e pavlefshëm të votimit.

Kërkuesi Partia Konservatore:

- Nuk korrespondojnë procesverbalet e komisioneve të qendrave të votimit me votat në kutitë e votimit dhe janë falsifikuar firmat e votuesve në listat e zgjedhësve.

- Janë lejuar individë të paautorizuar të qëndrojnë pranë kutive të votimit dhe të diktojnë në favor të kandidatit të Partisë Socialiste.

- Janë futur në kutitë e votimit fletëvotimi për persona të cilët nuk kanë marrë pjesë në votime.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Kujtim Puto, kërkuesit e përfaqësuesit e tyre, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Në zgjedhjet e pjesshme të datës 7.7.2002, komisioni i zonës zgjedhore nr.19 ka shpallur fitues kandidatin e Partisë Socialiste, Ardit Kaja, me 6579 vota pro (50.57 % të votave të vlefshme) kundrejt 5761 të votave të hedhura në favor të kërkuesit Gafur Muka, kandidat i subjektit elektoral PD+BF.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.54, datë 10.7.2002, ka rrëzuar si të pambështetur në ligj, kërkesën ankimore të kërkuesit Gafur Muka.

Si kërkuesi Gafur Muka, ashtu edhe Partia Konservatore e Shqipërisë i reduktuan kërkesat gjatë gjykimit në pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të njëjtat qendra votimi.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese, doli se komisionet e qendrave të votimit nr.19, 21, 22, 27 e 41 të zonës nr.19 të zgjedhjeve kanë lejuar shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit, shkelje që konsistojnë në votimin e një personi në emër të familjarëve. Kjo i bën zgjedhjet të pavlefshme, në kuptim të nenit 113/1 të Kodit Zgjedhor.

Megjithëse komisionerët e qendrave të votimit dhe të zonës zgjedhore nuk kanë pasqyruar në tabelat e rezultateve vërejtjet për këtë shkelje ligji, kërkuesi Gafur Muka paraqiti në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në Gjykatën Kushtetuese vendimin nr.10, datë 8.7.2002 të komisionit të zonës zgjedhore, duke kërkuar shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në ato qendra. Ekzistenca e këtij vendimi nuk është kontestuar nga palët dhe, për më tepër, pakica prej tre anëtarësh ka pasqyruar në të mendimin e vet.

Kërkuesi paraqiti, gjithashtu, një procesverbal të komisionit të qendrës së votimit nr.19 Boçevë, të mbajtur ditën e votimit, në të cilin 6 nga 7 anëtarët e komisionit kanë pranuar të “votohet edhe për anëtarë të familjes, përjashtuar emigrantët”.

Gjykata Kushtetuese administroi si prova listat e zgjedhësve të përdorura gjatë votimit, të cilat kanë vlerë vendimtare provuese për çështjen. Kjo Gjykatë konstatoi se në një shumicë rastesh dhe në mënyrë të dukshme kishte nënshkrime të njëjta për votues të një familjeje, gjë që bën bindës pretendimin e kërkuesit se ka votuar një person edhe për anëtarët e tjerë të familjes. Votimi i një personi për të tjerët cenon parimin e votës vetiake, parashikuar në nenin 45/4 të Kushtetutës. Si Kushtetutat edhe nenet 6 e 98/1 të Kodit Zgjedhor mbajnë qëndrim rigoroz kundër çdo shkelje të këtij parimi dhe përcaktojnë rregulla të detajuara për të shmangur cenimin e kësaj të drejte politike. Çdo shmangie prej tyre të çon në pasoja për gjithë procesin zgjedhor.

Nga gjykimi i çështjes rezultoi se komisionet e lartpërmendura të qendrave të votimit, në kundërshtim me ligjin, kanë lejuar me marrëveshje të komisionerëve që zgjedhësit të votojnë në emër të familjarëve të tyre. Jo vetëm kaq, por Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka bërë verifikime e nuk ka mbajtur qëndrim ndaj kësaj shkelje të rëndë të ligjit, aq në tepër që ishin mundësitë sepse listat e zgjedhësve ndodheshin jashtë kutive të votimit, siç e pohon vetë ky komision në shkresën nr.666/2, datë 25.7.2002 që i ka dërguar Gjykatës Kushtetuese.

Duke marrë parasysh rezultatet e zgjedhjeve në atë zonë dhe sidomos numrin e votave që kanë marrë kandidatët për deputetë të subjekteve elektorale PS e PD+BF, del se shkeljet e mësipërme kanë lidhje të drejtpërdrejtë me rezultatit përfundimtar në zonë dhe kanë ndikuar në fitimin e mandatit ose në moskalimin në raundin e dytë të zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 113/5 të Kodit Zgjedhor, si dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.93, datë 10.7.2002 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesëshme të datës 7.7.2002, për deputet të drejtpërdrejtë në zonën zgjedhore nr.19”, duke shpallur të pavlefshme zgjedhjet në qendrat e votimit nr.19 Boçevë, nr.21 Okshatinë, nr.22 Kovashicë, nr.27 Gjuras e nr.41 Okshtun i Vogël.

- Urdhërohet zhvillimi i raundit të parë të zgjedhjeve për deputet të drejtpërdrejtë në qendrat e mësipërme të votimit.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr. 171, datë 30.7.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar	i	“	“
Gjergj Sauli	Anëtar	i	“	“
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 5.6.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.115 Akti që i përket:

KËRKUES: KRYEMINISTRI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga juristët Zhani Shapo e Rezar Veseli, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, në mungesë.

2. KOMISIONI I SHËRBIMIT CIVIL, përfaqësuar nga zoti Roland Përmeti.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i nenit 22 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”.

BAZA LIGJORE: Nenet 131 e 134/1 “b” të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e dispozitës së mësipërme kërkuesi ka parashtruar këto pretendime:

Neni 22 i ligjit “Statusi i deputetit” bie në kundërshtim me nenet 18 dhe 107 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ligji “Statusi i deputetit” përjashton një kategori të caktuar personash dhe, konkretisht, ish-deputetët nga rregulli i konkurrencës për caktimin e tyre në administratën publike. Prandaj, si i tillë ky ligj vjen në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës, në të cilin është sanksionuar parimi i barazisë para ligjit që nënkupton edhe parimin e barazisë së shanseve për t’u pranuar në funksione publike.

Neni 107 i Kushtetutës parashikon që përjashtimet nga rregullat e konkurrencës për caktimin në administratën publike mund të bëhen me ligj për “raste” të veçanta. Këto raste janë përjashtimi nga konkurrimi për “funksione” apo “kategori funksionesh”, dhe jo përjashtim personash.

Rregullimet e nenit 22 të ligjit “Statusi i deputetit”, në vështrim të nenit 107 të Kushtetutës, nuk përbëjnë rast përjashtimor për pranimin në shërbimin civil, por rregull të përgjithshëm, për këto arsye: Së pari, nuk ka limit në kohë, brenda të cilit deputeti mund të ushtrojë të drejtën e punësimit në shërbimin civil dhe së dyti, pozicionet për të cilat mund të ushtrohet kjo e drejtë janë të kufizuara në numër dhe në nivele përcaktuese të shërbimit civil.

Neni 22 i ligjit të mësipërm vjen në kundërshtim edhe me tërësinë e parimeve të miratuara me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Në ligjin nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit", në nenin 22 të tij parashikohet që deputetët që nuk kanë arritur moshën e pensionit pas mbarimit të mandatit kanë të drejtë të punësohen në profesionin e tyre. Në këtë dispozitë parashikohet gjithashtu se organet e administratës shtetërore janë të detyruara t'i ofrojnë deputetit, brenda 1 (një) viti nga koha e mbarimit të mandatit si deputet, një vend pune në përputhje me kualifikimin e tij profesional, duke i dhënë statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë ose të mesëm drejtues.

Me kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë ka kërkuar deklarimin si të papajtueshme me Kushtetutën të dispozitës së mësipërme, me argumentin se ajo vjen në kundërshtim me nenet 18 dhe 107 të Kushtetutës dhe me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Gjykata Kushtetuese, duke shqyrtuar nenin 22 të ligjit "Statusi i deputetit", në frymën e normave kushtetuese, çmon se rregulli i parashikuar në të për caktimin e deputetëve në shërbimin civil pas mbarimit të mandatit, pa iu nënshtuar rregullit të konkurrimit, nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën.

Duke iu referuar nenit 18 të Kushtetutës rezulton se kjo dispozitë, në paragrafin e parë sanksionon parimin e përgjithshëm të barazisë përpara ligjit, kurse në paragrafin e dytë, ndalon disa forma të veçanta të diskriminimit, kryesisht ato që bazohen në "gjini, racë, fe, etni, etj...". Nisur nga përmbajtja e nenit 22 të ligjit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese konkludon se ky nen nuk bie në kundërshtim me dispozitën e mësipërme kushtetuese. Kjo për faktin se deputetët dhe konkurruesit e tjerë kanë pozita të ndryshme me njëri-tjetrin dhe për pasojë përjashtimi i ish-deputetëve nga konkurrimi, i bërë pikërisht për shkak të pozitës së tyre, nuk cenon parimin kushtetues të barazisë para ligjit dhe as nuk përbën ndonjë formë të veçantë diskriminimi.

Gjykata Kushtetuese, duke konkluduar si më sipër, konfirmon edhe një herë qëndrimin e shprehur me vendimin e saj nr.11, datë 27.3.1993 sipas të cilit: "Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë objektivisht në kushte të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta."

Në kundërshtim më sa pretendohet në kërkesë, neni 22 i ligjit "Statusi i deputetit" nuk vjen në kundërshtim as me paragrafin e dytë të nenit 107 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite: "Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji." Siç shihet, në Kushtetutë përcaktohet qartë rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit, caktimi i nëpunësve në administratën publike bëhet me konkurs. Por, nga ana tjetër, Kushtetuta, në nenin e mësipërm lejon, që me ligj, mund të bëhet përjashtim nga ky rregull. Bazuar pikërisht në këtë përjashtim të parashikuar në Kushtetutë, ligjvënësi nëpërmjet ligjit "Statusi i deputetit" ka lejuar që deputetët të punësohen në administratën publike pa konkurs.

Nga përmbajtja e nenit 22 të ligjit "Statusi i deputetit", rezulton se deputetëve u njihet e drejta e caktimit në punë në administratën publike, sipas profesionit të tyre, pa konkurs dhe në poste të larta ose të mesme drejtuese. Gjatë shqyrtimit të çështjes, pala kërkuuese e kufizoi kërkesën e saj për antikushtetutshmërinë e dispozitës së mësipërme vetëm për pjesën me të cilën kjo dispozitë u njeht deputetëve të drejtën e statusit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë ose të mesëm drejtues.

Edhe për këtë çështje Gjykata Kushtetuese vlerëson se argumentet e parashtruara nga pala kërkuuese nuk kanë të bëjnë me antikushtetutshmërinë e dispozitës që atakohet. Ato i referohen më tepër karakterit praktik të zgjidhjes së problemit të sistemit në punë të deputetëve pas mbarimit të mandatit të tyre. Çështja nëse deputetët do të caktohen si nëpunës civilë të nivelit të lartë a të mesëm dhe nëse është e drejtë që atyre t'u rezervohet një trajtim i tillë, është çështje që ka të bëjë me oportunitetin dhe dobishmërinë e rregullimit të statusit të deputetit, gjë që është atribut i organit ligjvënës dhe nuk ka të bëjë me antikushtetutshmërinë e nenit 22 të ligjit të mësipërm.

Gjykata Kushtetuese, në lidhje me pretendimin e parashtruar në kërkesë se neni 22 i ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”, vjen në kundërshtim me parimet e sanksionuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, konkludon se ky pretendim nuk mund të jetë objekt shqyrtimi në këtë gjykim sepse kjo Gjykatë shqyrton kushtetutshmërinë e ligjeve, e jo pajtueshmërinë e tyre me ligjet e tjera.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/a të Kushtetutës, si dhe neni 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 172, datë 31.7.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar	i	“	“
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“
Petrit Pllaçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Zija Vuci	Anëtar	i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 15.7.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.147 Akti që i përket:

KËRKUES: XHEMAL KORESHI, përfaqësuar nga avokat Zef Nika, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. HANIFE, SALUSHE, ISLAM, ELIDA E NAMIK KORESHI, përfaqësuar nga avokat Kozma Jano, me prokurë dhe deklaram.
2. FAHRIJE KURTI, përfaqësuar nga avokat Kozma Jano, me deklaram.
3. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, në mungesë.
4. BASHKIA LUSHNJË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.31, datë 20.1.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; nr.236, datë 21.2.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.Xh-3, datë 17.7.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f e 134/g të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e këtyre vendimeve kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

- Subjektet e interesuara që janë motra dhe vëllezër të kërkuesit, nuk legjitimohen në ngritjen e padisë për anulimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Lushnjë.

Lidhur me këtë shkak, kërkuesi ka këmbëngulur se sipërfaqen e tokës-arë dhe një pjesë të ullishtës e ka fituar në pronësi në bazë të ligjit për tokën me vendim të komisionit të ndarjes së tokave, dhe jo si trashëgimtar i babait të tij, Isuf Koreshi. Sipas tij, gjykata ka gabuar që në këtë rast ka zbatuar ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronave të vitit 1993, duke e ndarë këtë pronë në pjesë të barabarta midis tij dhe subjekteve të interesuara, si trashëgimtarë të ishpronarit, Isuf Koreshi. Kolegji Civil dhe Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë vendosur në dhomën e këshillimit, kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor për shkak se këtë çështje ata ishin të detyruar ta kalonin për shqyrtim në seancë gjyqësore për t'i dhënë përgjigje këtij problemi ligjor që përmban rekursi.

- Mosformimin i rregullt i ndërgjyqësisë, është një shkelje tjetër kushtetuese dhe kërkuesi pretendon se në gjyq nuk është thirrur si i paditur Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Lushnjë.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Zija Vuci, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr.100, datë 20.1.2000 ka vendosur ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr.105, datë 8.11.1999 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Këshillit të Rrethit Lushnjë, duke urdhëruar që toka e kthyer vetëm në pronësi të kërkuesit të regjistrohesh në bashkëpronësi midis tij dhe subjekteve të interesuara.

Mbi ankimin e kërkuesit, çështja është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr.233, datë 9.5.2000, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së faktit.

Duke mos u pajtuar me këtë zgjidhje, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë, por Kolegji Civil dhe Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara, me vendimet nr.236, datë 21.2.2001 dhe nr.Xh-3, datë 17.7.2001, kanë vendosur në dhomën e këshillimit, mospranimin e rekurseve të tij kundër vendimeve të sipërme të gjykatës së apelit dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Gjykata Kushtetuese, pasi shqyrtoi kërkesën për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre vendimeve, çmon se shkaqet që ka ngritur kërkuesi, janë të pabazuara.

Kështu, pretendimi i tij për mosformimin e rregullt të ndërgjyqësisë, duke mos u thirrur si i paditur Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Lushnjë, vendimi i të cilit është kundërshtuar me padi nga subjektet e interesuara, nuk i përgjigjet realitetit.

Përkundrazi, nga aktet që ndodhen në dosjen gjyqësore del se padia është ngritur kundër këtij organi dhe ky është njoftuar rregullisht për ditën e gjyqit. Për më tepër, në vendimin që ka dhënë për këtë çështje gjykata e shkallës së parë, ai figuron si palë e paditur e gjykuar në mungesë dhe nuk rezulton që mosparaqitja e tij në gjyq të ketë ardhur për shkaqe të përligjura.

Në këto rrethana, Kolegji Civil dhe Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u nisur nga fakti se pretendimi i sipërm i kërkuesit rrëzohet me dokumentet që ndodhen në dosje, me të drejtë e kanë zgjidhur këtë çështje në dhomën e këshillimit, pa e kaluar atë për shqyrtim në seancë gjyqësore.

E pabazuar është kërkesa objekt gjykimi edhe në pjesën që pretendohet, se gjykata ka zbatuar gabim ligjin material dhe se për këtë, sipas kërkuesit, këto Kolegje të Gjykatës së Lartë, u detyruan të vendosnin në dhomën e këshillimit, mospranimin e rekurseve të tij, dhe ta kalonin këtë çështje në seancë gjyqësore.

Problemi që ai ka ngritur si shkelje të ligjit material nga ana e këtyre instancave gjyqësore, nuk ka të bëjë me mosrespektimin e normave kushtetuese që garantojnë të drejtën themelore për një proces të rregullt ligjor.

Kjo, për arsye, se si në rekurset drejtuar Gjykatës së Lartë edhe në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi, ka bërë vetëm analizë dhe vlerësim provash, duke i çmuar ato në mënyrë të ndryshme nga gjykata e rrethit dhe gjykata e apelit. Prandaj, në këtë rast problemi që ai ka ngritur nuk ka të bëjë as me shkelje të ligjit material, në kuptim të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile dhe për rrjedhojë me procesin e parregullt ligjor

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare.

VENDIM

Nr. 101, datë 23.7.2002

PËR VLEFISHMËRINË DHE HEQJEN E LICENCAVE PËR DISA SUBJEKTE RADIO E TELEVIZIVE

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 137 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit nr.97, datë 7.6.2002 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Bëhet e pavlefshme licenca e operatorëve radio FM e televizive të licencuar që, sipas nenit 33 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, nuk kanë tërhequr licencën, nuk janë regjistruar në organet tatimore, nuk kanë shlyer pagesën vjetore të licencës dhe taksat vjetore për vitin 2001, si më poshtë:

Nr.	Emri i subjektit	Adresa	Lloji i licencës
1.	Radio AH	Tiranë	Radio FM vendore
2.	TV Bulqiza	Bulqizë	Televizion vendor
3.	TV Durrësi	Durrës	Televizion vendor
4.	TV Era	Ersekë	Televizion vendor
5.	TV me kabëll AVN	Fier	Televizion kabllor
6.	TV Kurbini	Kurbin	Televizion vendor

2. U hiqet licenca me kërkesën e tyre subjekteve:

Nr.	Emri i subjektit	Adresa	Lloji i licencës
1.	Radio Antena Jug	Gjirokastrë	Radio FM vendore
2.	Radio Gramshi	Gramsh	Radio FM vendore
3.	Radio Intervista	Tiranë	Radio FM vendore
4.	Radio Nesër	Tiranë	Radio FM vendore
5.	TV ABC	Korçë	Televizion vendor

3. Në mbështetje të nenit 34 pika 5 u hiqet licenca subjekteve:

Nr.	Emri i subjektit	Adresa	Lloji i licencës
1.	Radio 101	Tiranë	Radio FM vendore
2.	Radio Kruja	Krujë	Radio FM vendore
3.	Radio Calvin	Tiranë	Radio FM vendore
4.	Radio Kontakt	Tiranë	Radio FM vendore

4. Subjektet kanë të drejtë të riaplikojnë për marrjen e licencës pranë Këshilit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, pasi të kenë shlyer detyrimet financiare, duke iu nënshtruar, në bazë të nenit 21 të ligjit të sipërcituar, konkurrimit të kandidaturave.

5. Subjektet, sipas këtij vendimi, janë të detyruar të ndërpresin menjëherë veprimtarinë.

6. Në zbatim të nenit 137/5 (“Bashkëpunimi me organet e tjera”) të ligjit nr. 8655, datë 31.7.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ngarkohet Policia Tatimore për ekzekutimin e këtij vendimi.

7. Ngarkohen Departamenti Juridik dhe i Licencave, Departamenti Teknik, Departamenti Ekonomik, në bashkëpunim me Policinë Tatimore për zbatimin e këtij vendimi.

8. Vendimi të publikohet në median e shkruar dhe elektronike, si dhe në faqen e internetit KKRT-së.

9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM

Nr. 102, datë 23.7.2002

PËR DHËNIE LICENCE PËR RITRANSMETIM TË PROGRAMEVE TË HUAJA RADIO NË SHQIPËRI “RADIO ITALIA”

SUBJEKTIT: “ALBANIA BROADCASTING SYSTEM” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit juridik “ALBANIA BROADCASTING SYSTEM” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator për ritransmetimin e programeve të huaja radio me përsëritëse, për një periudhë prej 4 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca përmban kushtet e licencës, ku përfshihen zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
(I SHKURTUAR)

Me vendimin nr.106, datë 8.7.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë ka vendosur të shpallë të zhdukur shtetasin Gjon Bib Nikolli dhe kujdestar për administrimin e pasurisë së tij të caktohet Ndue Bib Nikolli.

NDREQJE GABIMESH

1. Në Fletoren Zyrtare nr.24/2002, faqe 738, në ligjin nr.8892, datë 14.5.2002, neni 29 menjëherë pas nenit 28 hiqet, për arsye se teksti i nenit 28 është radhitur dy herë.
2. Në faqen 751, pika 3 “Lista e produkteve bujqësore dhe ushqimore të përpunuara nga Republika e Maqedonisë...” dhe në faqen 752 pika 4 “Produkte bujqësore dhe ushqimore të përpunuara të cilat, nuk përmenden në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij Aneksi...” kalon në faqen 761 pas pikës 2. (Pjesë e Protokollit A, Aneksi 2).

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 12.8.2002
Doli nga shtypi më 13.8.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë